

ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Nr. 30/2019

Prishtinë, 11.01.2019

**KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS**, duke vendosur lidhur me bojkotin e filluar më datë 05.01.2019, pas sqarimit të dhënë nga KGJK-ja më datë 11.01.2019 dhe takimit të Kryetarit të OAK-së me Ministrin e Drejtësisë, Kryesuesin e KGJK-së, Kryetarin e Gjykatës Supreme, të Apelit dhe Themelore të Prishtinës, në bazë të nenit 24, 25 të Ligjit për Avokatinë lidhur me nenin 95 par. 1.13 të Statutit të OAK, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 11.01.2019, në mënyrë unanime merr këtë:

#### V E N D I M

- I. PEZULLOHET PËRKOHËSISHT Vendimi i Këshillit Drejtues të OAK-së i datës 05.01.2019 për BOJKOT.**
- II. Kjo pasi që KGJK ka SHFUOIZUAR** Rekomandimin e datës 28.12.2018 dhe Urdhëresat e tjera në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- III.** Ky pezullim do të zgjasë për periudhën kohore prej 30 ditësh, brenda së cilës periudhe kohore, OAK dhe KGJK do të arrijnë marrëveshje për kërkesat për të cilat do të dakordohen bashkarisht.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi më datë 11.01.2019, ora: 17:00.

#### A r s y e t i m

Pas rekomandimit të dhënë nga ana e KGJK-së, më datën 28.12.2018 përmes të cilit ishte vendosur që t'u ndalohet çasja e avokatëve në objektet e gjykatave dhe duke urdhëruar që ky rekomandim të zbatohet edhe në Gjykata të tjera... OAK, e ndodhur në këtë gjendje, më datë 05.01.2019, mbajti mbledhje të jashtëzakonshme dhe mori Vendim unanim për të hyrë në Bojkot të Përgjithshëm, të gjithë Avokatët e Republikës së Kosovës.

Sipas kërkesës nga Kryesuesi i KGJK-së dhe Ministri i Drejtësisë, më datë 11.01.2019, Kryetari i OAK-së, ka marrë pjesë në takim në KGJK ku pjesëmarrës kanë qenë Abelard Tahiri, Ministër i Drejtësisë, Nehat Idrizi, Kryesues i KGJK-së, Enver Peci, Kryetar i Gjykatës Supreme, Hasan Shala, Kryetar i Gjykatës së Apelit, Afërdita Bytyqi, Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në këtë takim, OAK ka shprehur shqetësimet lidhur me kundërthënien e rekomandimit/vendimit të tyre të datave 28.12.2018 dhe 10.01.2019, që lë shumë hapësirë për interpretim dhe në këtë drejtim KGJK ka ardhur në përfundim që të bëjë një sqarim shtesë për OAK-në dhe Avokatët, se **“deri në përpilimin e rregullave të reja të çasjes në objektet e gjykatave, të zbatohen rregullat e para datës 28 Dhjetor 2018”**.

KGJK, pas takimit me Kryetarin e OAK-së, më datë 11.01.2019 ka dhënë një sqarim shtesë me shkrim përmes së cilit ka njoftuar OAK-në dhe Avokatët, se bëjnë terheqjen e Rekomandimit dhe veprimeve pas datës 28.12.2018.


Këshilli Drejtues duke vërejtur se tërheqja e rekomandimit të datës 28.12.2018, nënkupton shfuqizimin e saj, Këshilli u dakordua që të pezullojë përkohësisht bojkotin, në afat prej 30 ditësh, duke pritur se do të ketë reflektime konkrete nga KGJK, respektivisht akterët e tjerë e sistemit të drejtësisë.

Në bazë të asaj që u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

## KËSHILLI DREJTUES I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

Nr. 30/2019, datë 11.01.2019

Kryetar i Odës,  
Av. Osman Haxholli



Ky vendim u dërgohet:

- Avokatëve të OAK-së;
- Arkivit të OAK-së;
- Ministrisë së Drejtësisë
- KGJK-së dhe Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- KPK-së dhe Prokurorive të Republikës së Kosovës ;
- Policisë së Kosovës.

---

Adresa: Prishtinë, Rr. Bedri Pejani nr 31, Tel 038 244-586 e-mail: info@oak-ks.org